





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 26.02.2021, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.01.2021

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë të datës 28.01.2021.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 28.01.2021.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.01.2021 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, mungoi Vehbi Rama. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike, zyret e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Meqenëse është seanca e parë e rregullt për këtë vit, me lejoni që të ju uroj një vit të ri, një vit të mbarë dhe natyrisht një angazhim që të merrem me interesa të qytetarëve të Vitisë, meqenëse jemi në procesin zgjedhor, komuna jonë dhe nga anëtarët e kuvendit e kemi një numër të kandidatëve të vilet garojnë në zgjedhjen nacionale. Unë ju uroj suksese me dëshirën më të madhe që t’i shohim si pjesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Natyrisht është apeli im që të gjithë qytetarët e Vitisë të fokusohet dhe t’i votojnë anëtarët që vinë nga komuna jonë. Zyra Ligjore e MAPL-së naj ka konfirmu konfirmimin e ligjshmërisë e të gjitha akteve që i kemi miratu në seancën e kalume, që ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Një informim të shkurt lidhur me gjendjen Covid 19. Në bazë të të dhënave nga instituti i shëndetit publik, deri me tash në Komunën e Vitisë i kemi 51 aktive nga numri i përgjithshëm i rasteve që kanë qenë 1600 të infektuar, dhe të vdekur fatkeqësisht i kemi 48 nga Covid 19. Unë në emër tim dhe tuajin ju shpreh ngushëllime të gjithëve atyre familjeve që kanë humb me të dashurit e tyre dhe kërkoj që të kemi kujdes dhe t’i përmbahemi rregullave dhe sugjerimeve nga instituti i shëndetit publik të Kosovës. Tani po kalojmë në pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë ju shprehi ngushëllim të gjithë familjarëve që kanë pësuar nga Covid 19. Në seancën e kalume drejtorit të shërbimeve publike ja kam adresu një çështje lidhur me fshatin Skifteraj. Prapë nuk keni reagu tek poqat elektrik, ndriçimi publik, rruga “Sahide Ramadani”. Ndoshta ke harru, ndoshta është fillim viti, nuk e di. Kam një kërkesë po ashtu nga lagjja “Kamberi”, për shkak se kanë nevojë për ndriçim publik. Nuk e di këtë vit a do të hynë si projekt i investimeve kapitale, ndërsa sa i përket pyetjeve, i kame dy pyetje drejtuar për drejtoreshën e shëndetësisë. Kam pyetje nga qytetarët,

se kur do të fillohet me pagesat për ata familjar që kanë pësuar nga Covid 19. Po ashtu e kam edhe një pyetje, janë gjithsej dikun rreth 15 praktikant të cilët kanë qenë të kontraktuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Vitisë, pagesa e tyre mujore ka qenë 250 euro për një praktikant. Ministria i ka kry obligimet financiare, ndërsa komuna nuk i ka pagu që tre muaj punën praktike të tyre. Kjo është marrëveshje në mes ministrisë dhe komunës, dhe kandidatët po kërkojnë që Komuna e Vitisë të zbaton marrëveshjen që e ka me ministrin. Pse po ndodhë kjo vonesë, këta njerëz nuk janë pagu që tre muaj, janë gjithsej 185 praktikant.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam dy pyetje, një për drejtorin e arsimit. Me që kemi fillimin e vitit të ri shkollor, të gjithë mësimmshënësve të Komunës së Vitisë ju dëshiroj një vit të suksesshëm. Si ka qenë furnizimi me mjete sanitare dhe higjienike në këtë gjysmëvjetorin e dytë nëpër institucione shkollore të Komunës së Vitisë? Dhe një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, dijet që ka pas të reshura të mëdhaja: si është menagju dhe si ka qenë gjendja në Komunën e Vitisë? Kjo më asistoj me e be këtë pyetje se e lexova me një faqe ne facoebook ku thotë: “që ka vërshime ne Goshicë”. Tash, nëse ka në Goshicë, atëherë çka të koka bë me pjesën tjetër të Vitisë.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë! Kam një pyetje, pasi që nuk të koka kryetari, po e bëjë për nënkryetarin. Sa kanë kushtuar qeto klimat që janë të vendosura këtu në sallën e kuvendit komunal ku jemi ne.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Isha lidh me pyetje lidhur me fillimin e procesit mësimmor: a ka pas dezinfektim të shkollave para fillimit të gjysmëvjetorit të dytë ne shkollat e Komunës së Vitisë, cila është gjendja, a ki informata, a ka nxënësa dhe mësimmshënës me Covid, a ka fillu me kapacitet të plotë procesi mësimmor? Një përshkrim të gjendjes lidhur me procesin mësimmorë, kam kërkuar listën e të punësuarve përmes KARITAS-it në QKMF. Edhe sot nuk ma ka pru drejtoresha, prapë do të kërkoj në çdo seancë, deri sa të ma sjellë komplet atë listë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e kam një vendim i marr nga kryetari i komunës, i cili ka të bëjë me bartjen e mjeteve nga një projekt në projektin tjetër. Pra, me këtë vendim kryetari i komunës ka bë bartjen e mjeteve, rregullimi i asfaltit të rrugës Viti-Sllatinë e Ulët dhe rregullimi i fushës ndihmëse të futbollit në Pozharan. Këto mjete janë bartë për asfaltimin e rrugëve rurale. Pyes kryetarin, se a ka pas të drejtë ta bëjë këtë dhe sa mund të jetë shuma maksimale që mund ta bënë bartjen? Veçanërisht pyes drejtorin e financave, pasi që thotë, që mjetet nga neni I i këtij vendimi sigurohen nga Drejtoria e Financave. A është kjo mënyrë e rregullt ligjore apo a të ka paraqit ty problem për bartjen e këtyre mjeteve nga një projekt në projektin tjetër?

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë dua ta ngris një shqetësim në shkollën "Halil Alidema" në Pozharan. Nënkryetar, nëse mundesh me dal decitivish me e dhënë një përgjigje, se kur do të behet përfundimi i kësaj shkolle. Jemi në vitin 2021, po flasim për një shkollë që ka fillu premtimet prej vitit 2014. Paramendone tash ne vitin 2016 është premtu që do të përfundohet, pastaj është thanë në vitin 2017. Edhe sot është gjendja siç e dini ju pra, nuk ka asgjë decitive. Kryetari në emisionin “Jeta në Komunë”, ka thanë që do të përfundohet tash ne janar: Çka ka ndodhe me atë premtim? Tash si është e mundshëm në debate publike të jepni premtime në media elektronike. Unë ju lutem ne emër të banorëve të Pozharanit, të dilni dhe ta jepni një premtim, sepse nuk është diçka qe ju nuk mund ta dini, se përafërsisht kur mund të fillon mësimi ne këtë shkollë.

z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit: znj.Liridona, është e drejtë e çdo këshilltari komunal të ngris shqetësime. Po pyetjet që i parashtroni është mirë t'i bazoni në fakte dhe argumente me data të sakta. Të thuash është premtu, unë e di që gjatë fushatave të ndryshme zgjedhore që janë mbajt prej mas luftës, secili që ka ardh në Pozharan për interesa të veta, për vota ka premtu që do të me shini me lopatë tu e vendos gurthemelin dhe kjo nuk ka ndodhë asnjëherë. Unë po ju thamë me përgjegjësi të plotë, shkolla në Pozharan ka fillu gurthemelin, është vendos me 28 Nëntor 2016. Po thuaj që vitin 2017 nuk ka punuar hiq kurgja dhe më vonë është e vërtetë që projekti i shkollës në Pozharan është projekt i nivelit qendror. Trusni më të madhe që ka bë nënkryetari, kryetari

dhe unë si kryesues i kuvendit ne organet që janë kompetente dhe fatkeqësisht e kemi pas një operator shumë të papërgjegjshëm, i cili i ka zvarritë punët.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kryesues, ti po thu që ka fillu projekti me 28 Nëntor 2016. Është e saktë, taman e saktë, mirëpo projekti është dyvjeçar dhe ka qenë dashur me përfundim në 2018. Tash jemi ne vitin 2021, operatori është i papërgjegjshëm. Ekzistojnë sanksionet që duhet me e eliminu edhe me tenderu. Kryesues, mos fol sene që nuk duhet me i fol, papërgjegjësi totale e qeverisë komunale është kjo, mos e arsyeto qeverisjen komunale, ku po qëllonjë vetëm në Pozheran operatorët që nuk kryen punë të mira. Qashtu me stadiumin “Ibrahim Kurteshi”, qashtu me shkollën “Halil Alidema”.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Po me vjen keq edhe prej teje që po dezinformon. Projekti dhe faza dinamike ka qenë me përfundim nëntorin i vitit 2019. A turpërohesh ti nëse nuk është qashtu dhe a mbanë përgjegjësi penale para të gjithë këtyre. Shikojmë e vërtetojmë, nëse nuk është nëntori i vitit 2019. Është çështje tjetër që unë dhe ti duhet me bë përpjekje shumë tek operatorët e papërgjegjshëm me reagu qysh kam reagu unë disa herë, ka qenë dashur edhe ti si këshilltar me reagu, ndoshta edhe protesta me organizu.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kryesuesi e filloj mjaft mirë sot me një urim për kandidatët që i kemi pretendent për me qenë në Kuvendit e Republikës se Kosovës. Mendoj që kjo kohë deri ne zgjedhje duhet të orientohet pikërisht ne këtë drejtim, që ta ndalim votën këtu dhe të përfaqësohemi me njerëz tanë, e cila është një e metë e madhe në komunën tone. Mirëpo, fatkeqësisht sipas informacioneve shumë të sakta, kemi fillu mbrapsht. Ju që jeni ne qeverisjen komunale nuk e di me çfarë morali i bani fushatat, shkoni dezinformoni, se ne po financohemi nga Serbia dhe nga Rusia, me argumente po flasë. Nëse doni me hi andej, kemi me qu deri ne fund. E dina edhe kush u kanë me Serbinë. Po bëjë thirrje me i ndal këto, ju kërkoj që këto mos të ndodhin ma. Po e kam një pyetje edhe për drejtorin e arsimit në shkollën e Gushicës. Është kry një projekt me efijenc nga Qeveria e Republikës së Kosovës: sa ka kushtu ky projekt, e du shumë e saktë?

z.Nuredin Lutfiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa kërkesa nga banorët e fshatit Skifteraj dhe banorët e qytetit të Vitisë. Për drejtorin e financave kamë disa kërkesa. Rruga “21 Shtatori” dhe rruga “Luftëtarët e UCK-së”, banoret e asaj rruge kanë kërkesë për ndriçim publik dhe tretuar. Rruga “17 Shkurti”, rruga “15 Prilli” kanë nevojë për asfalt jo për riparim të asfaltit po për asfalt të ri. Ndërsa rruga “Flakadanët e Lirisë”, rruga “Metush Ismajli”, rruga “Feriz Rama” kanë nevojë urgjente për tretuar, sepse kjo rrugë ka qarkullim të shumë automjeteve, këtë e dinë edhe nënkryetari, sepse në atë rrugë kalon shpesh. Ndërsa rruga “Rrust Sadiku”, ka nevojë për shtrim të asfaltit, për bashkëngjitje me rrugën kryesore. Ndërsa sa ju përket banorëve të qytetit të Vitisë, kemi kërkesë nga rruga “14 Qershori”, që është kërkesa e pestë apo e gjashtë që e bëjë për një posetë që është në mes të rrugës. Ju lutem me intervenu aty!

znj.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Me së pari ju shprehi ngushëllim me të thella atyre që kanë humbur me të dashurit e tyre, pastaj për pagesa që ende nuk i kemi bë, janë dy arsye. Sistemi ka qenë i mbyllur për pagesa dhe e dyta, zyrtarin financiar e kemi pas në pushim mjekësor, ka qenë i infektuar me Covid dhe sot ka qenë dita e parë që ka fillu me punu. Bekim, e njëjta përgjigje është si me parë, ki qasje në dokumente zyrtare. Të drejtën e ki plotësisht edhe mundesh me kerku, e se shpejti do t’i bëjmë, do t’i procedojmë tutje, ndërsa për ata qe janë praktikantë, drejtori i financave ndoshta e ka përgjigjen me adekuate.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, prej *Emi Center* deri tek Administrata e *Hidromoraves* janë dikune 8-9 poqa elektrike që nuk po punojnë. E bëjë kërkesë me i nderru ato poqa. Edhe para Viti të Ri një kompani i ka ndërtu disa puseta të dimensionit të mëdha, sigurisht aty ku nalet uji një posetë e madhe është ndërtu me dimension dikune 2 me 3, aty tek rrethi në Kabash është prish ka shafu ajo edhe një puset tjetër. Është ndërtu rruga e Debuldeve, që shkon te poshtë me dal tek udhëkryqi i

Pozharanit, edhe aty është një pusët që është ndërtua shumë e madhe, 2 me 3, edhe ajo është shkatërru, është mirë me i vizitu ato poseta edhe me i thirr ndërtuesin, që me intervenu aty, sepse 10 santi vetëm kanë sharru ato.

z.Ibrahim Rama, drejtor i financave: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetja e Remzi Salihut që ka të bëjë me bartjen e mjeteve nga një projekt në projektin tjetër sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kryetari i komunës nëse nuk gabo, nënë 82 ose 83 thotë: kryetari i komunës ka të drejtë 5% brenda kategorisë ekonomike t'i bartë mjetet prej një projekti në projektin tjetër, kurse nga një kategori ekonomike në tjetrën nuk ka të drejtë përveç kuvendit komunal. D.m.th brenda për brenda kategorive ekonomike kryetari i komunës ka të drejtë me i bartë mjetet prej një projekti në projektin tjetër. Dhe pyetja tjetër nga Mirlinda Sadiku, ka të bëjë me pagesën e punëtorëve që janë bashkëfinancu nga Ministria e Punës dhe Komuna e Vitisë një pagë jemi minus në bazë të asaj pjese që kemi pas mundësi me i pagu, kurse pagën e dhjetorit nuk kemi mujt me e mrri, se dikun sistemi është mbyll me 24 dhjetor. Realisht zotimet janë mbyll edhe me herët, dikun me 21 dhjetor, kështu që jemi kanë në pamundësi me i realizu pagat e fundit, po unë besoj që këtë javë mjetet na kanë dal, në javën e ardhshme fillojmë me e i be pagesat. Vendimet i kemi dhe jemi në rregull për pjesën tonë me e pagu.

z.Basri Aliu, drejtori i arsimit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U bënë disa pyetje, sidomos pyetja e parë ishte nga asamblisti Aliu për mjete sanitare dhe higjenike. Sa është përgatitur fillimi i vitit shkollor nëpër shkolla, ne edhe përmes investimeve komunale, përmes shërbimeve dhe mallra kemi bënë furnizimin për të gjitha shkollat dhe jemi furnizu mjaftë me mjete dezinfektuese dhe higjenike. Gjithashtu kemi marr edhe një donacion prej UNICEF. Çka mund të them që gjendja nëpër shkolla është e kënaqshme me furnizim me mjete dezinfektuese dhe higjenike. Bekimi e përmendi dezinfektimin e shkollave. Realisht atë që e thash për Aliun, në të gjitha përgatitjet i kemi bënë për shkolla dhe kemi ble për çdo shkollë nga një pumpë dhe material dezinfektues që ata ta bëjnë dezinfektimin vetë, ndërsa sa i përket dezinfektimit të përgjithshëm të deminacional që po e quajmë ato çdo 6 muaj, edhe sipas ligjit duhet të dezinfektohen. Ne realisht ende nuk i kemi bënë 6 muaj prej dezinfektimit të fundit, kështu që çdo shkollë e ka pompën dhe mundet brenda javës ta bëjnë dezinfektimin. Material dezinfektues ka mjaftë, po shpresoj që përdoret ashtu siç duhet dhe rregullat sipas manualit për Covid të zbatohen në çdo shkollë. Sejdi, sa ka kushtu as unë nuk e di, po do të interesohem, sepse nuk është projekt i komunës, është projekt i ministrisë dhe i Bashkimit Evropian, kështu që ne vetëm mujmë me marr një shifër me e kërku dhe me ta sjellë ty për neve. Po besoj që edhe për juve ka qenë i mirëseardhur, po kemi me i bënë edhe shkollat tjetra në këtë vit, kemi me i bënë edhe shtatë shkolla, kështu që është një sukses i mirë për arsimin në Viti që izolohehen këto shkolla.

z.Negjmedin Jakupi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U bënë disa pyetje për drejtorin tonë, një pyetje ishte rreth situatës që e patëm me 10 -11 nga reshjet e mëdhaja të shiut, të cilat jo vetëm që e përfshinë tërë Kosovën. Fatmirësisht ne e patëm një gjendje shumë më të mirë se komunat e tjera, të cilat u ballafaquan me dëme të mëdhaja nga vërshimet dhe përmytjet, si në ekonomit familjare dhe në tokat pjellore. Gjatë datës 10 - 11 tërë natën ekipet reaguese, njësitë profesionale i zjarrfikësive ka reagu mbi 15 raste. Rastin më të rëndë e kemi pas në Drobesh, tek një familje e cila ka qenë e detyrume të evakuohen nga shtëpitë e tyre. Kemi pas përmytje të oborreve, më së shumti kemi pas përmytje të oborreve dhe disa shtëpi. Fatmirësisht edhe "Morava" ka ndiku që ka qenë e pastrume për mos me qenë dëmet më të mëdhaja dhe vërshimet me të mëdhaja. Po edhe proçkat që vazhdimisht çdo vit po pastrohen, me keqardhje duhet me thanë që nëpër disa proçka shkaktari kryesor kanë qenë mbeturinat të cilat po hedhen nga qytetarët e papërgjegjshëm dhe këto kanalet kulluese po i bllokojnë. Prandaj po kemi reshje të mëdhaja të shiut. Ai ujë po del në sipërfaqe të tokës nga komisioni për vlerësimin e dëmeve të cilin e ka themelua kryetari menjëherë pas kësaj situatë. Shifet se dëmet me të mëdhaja i kemi në tokat bujqësore, dikun me një vlerë mbi 40 mijë euro. Bazë vlerësimi që i është bënë komisioni, ndërsa në ekonomitë familjare kemi shumë dikun afër 5000 euro, i kemi dikun 5-6 kërkesa që ju ka hi uji në podrume, kanë pas

dëmtime. Patë edhe disa pyetje nga Mirlinda për ndriçimin publik. Unë kam mëndur që kjo është rregullu në fshatin Skifteraj, po besoj që do të zgjidhet ky problem. Sameti e ngriti shqetësimin rreth poqave dhe pusëtës. Besoj që edhe këto do të rregullohen. Posetat i kemi të identifikuar dhe në Pranverë do të rregullohen. Duhet me pas parasysh se i kemi 11 mije trupa ndriçues krejt territorin e Komunës së Vitisë. Disa poqa dikun djegën ose prishen dikun rregullohen, duhet me pas parasysh këtë. Unë apeloj tek ju këshilltar komunal, që t'i ngritni këto çështje këtu në kuvend. Po e keni telefonin e drejtorisë ose një kërkesë në drejtori dhe nuk ka nevojë me prit në kuvend për kështu tema. E kemi një bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave, munden edhe ata me e sjell kërkesën.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Jakupi pyeti për nxemjet e kuvendit. Këto i kemi bërë në si kuvend, ndërsa procedurat i ka udhëheq Zyra e Prokurimit. me thanë të drejtën nuk e di shumë e saktë, po drejtorja mundet me naj sjellë informatën.

z.Remzi Saliu: Drejtori na tregoj se sa përqind ka të drejtë kryetari ta bëjë bartjen e mjeteve. Po unë po pyes se është shuma totale për projektet totale. Rregullimi i asfaltit rrugës Viti-Sllatinë e Ulët dhe rregullimi i fushës ndihmëse të futbollit në Pozharan, sepse e para ka mbi 30 mijë, ndërsa kjo e dyta ka 50 mijë, e kur t'i llogaritësh nga 5%, po dalin një shumë bukur e madhe. A mundesh me naj dhanë shumë totale të këtyre dy projekteve?

z.Ibrahim Rama, drejtor: Unë u përgjigja edhe me herët, 5% brenda për brenda kategorisë ekonomike. Kryetari i komunës ka të drejtë mbi 5%, duhet me e konsultu kuvendin komunal, me e marr pëlqimin, kështu që fusha ndihmëse në Pozharan 50 mijë euro janë bartur nga fusha ndihmëse në Pozheran, 30 mije është bartja nga projekti, rregullimi i rrugës Viti-Sllatinë e Ulët. Këto krejt bëjnë 80 mijë euro, ose përqindja prej 5% në kuadër të investimeve kapitale. Është më shumë se 140 mijë euro, kështu që jemi brenda për brenda kufijve të ligjit që na lejon me bë bartje brenda projekteve. Totali i fushës ndihmëse në Pozharan ka qenë dikun 220 e diçka mijë euro, kurse rruga Viti-Sllatinë e Ulet është vlera (financohet) 70 mijë euro u kanë për këtë vit nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe 60 mijë euro nga buxheti i Komunës së Vitisë. 130 mijë euro ka pas mu investu këtë vit, d.m.th vitin 2020.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Shfrytëzoj rastin të gjithë kandidatëve që janë në lista për këto zgjedhje të ju uroj suksese. Sejda e ngriti një shqetësim në rast se ka asi linqime, etiketime të cilat edhe mu më shqetësojnë si personalitet, u kanë mire me e marr një iniciativë nga krejt subjektet politike me e nënshkru një marrëveshje që ta ruajmë atë kodin e etikës së zgjedhjeve, po jo të humbim kohë në kuvend, sepse nuk është temë debati. U parashtruan disa pyetje. Jakup, në seancën e radhës do ta kesh shumë se sa kanë kushtu nxemjet këtu në kuvend. Ishte një pyetje rreth shkollës së Pozheranit. Unë e kuptoj një qytetar të Komunës së Vitisë kur e bënë këtë pyetje, po nuk muj me e kuptu një këshilltar apo këshilltare komunale, e cila ka një provoj pune në kuvend komunal 3 vite, pse për shkak se jam i bindur që edhe ti do procedura i dinë shumë mirë, gati si unë, ndoshta edhe më shumë, po megjithatë me shfrytëzu në aspekt të asaj, që ndoshta te grumbullimit të votës, atë nuk e dëshiroj. Pse po e thamë këtë, e shpjegoj kryesuesi afatin, po gjithherë duhet me e ditë, se projektet të cilat ti nuk je financues, je kërkues. Na jemi kanë në rolin e kërkuesit, kemi has në mirëkuptim, kanë ardh, e kemi fillu shkollën, ka qenë në 2019 me përfund, nuk ka përfund, dhe në shkurtimet buxhetore të cilët i kanë bërë kanë than përfundon në vitin 2020, në rast se më se shumti brenda 8 viteve dhe kanë qenë në Prishtinë me trokit dyerve për dy projekte, ka qenë stadiumi i Pozheranit dhe shkolla e Pozheranit, dhe thirrjet telefonike të pandërprera. Çka ndodhë në miratimin e buxhetit për shkak vitit të pandemisë që janë thirr ata, e kanë bërë një shkurtim të buxhetit dhe 250 mijë investime i kanë qit për vitin 2021. Këtë çka po e flas ta argumentoj me dokumente të cilat i flasë përkundër asaj trysnie të pandërprerë të cilën e kemi bërë udhëheqja komunale prej Sokol Halitit e deri te kryesuesi i kuvendit, bile bile edhe organizim të takimeve të tilla për të cilat kemi ardh në përfundim ndërprerje të punimeve pas ati debati të cilët kanë qenë edhe të përfaqësuesit të ministrisë, ku kam qenë edhe unë pjesë edhe kryesuesi i kuvendit dhe kryetari, dhe tu i pas

parasysh ligjet që i kemi në fuqi, kemi ardh në përfundim se përfundimi i kontratës naj shtyke punën më shumë se qekey operatori i papërgjegjshëm, se kemi ardh në situatë të përfundimit, sepse deri sa u shpallke një fitues tjetër të zgjedhet kane ankesa, prandaj hymë vitin 2021 me një ndarje të buxhetit prej 250 mije euro. Shumë besoj që do të përfundohet shkolla. A kemi qenë ne si qeveri komunal të kënaqur me operatorin ekonomik dhe ecurit e zhvillimit të punimit në shkollën e Pozharanit, them jo, po këto kanë qenë mundësitë tona, përpjekjet kanë qenë maksimale, të gjithë ata të cilët janë kanë të interesuar për këtë çështje e dinë në rast se krejt kësaj sërisht ti nuk i beson, hajde në zyrën time ti jap numrat e telefonave, ti jap njerëzit dhe ti shko verifikoe, cilat kanë qenë përpjekjet tona. Në lidhje me këtë proces nuk ka mujt të shtyhet më shumë, kaq ka qenë potenciali jonë si qeveri komunale për me shty këtë proces, prandaj unë konsideroj që edhe nxënësit të cilët kanë pas nevojë edhe personeli arsimor edhe ne si strukturë udhëheqëse nuk e kemi meritu këtë, e kemi meritu një dinamik më të shpejtë, po megjithatë kjo ka ndodh. Po një fat i mirë ajo që na sjellë, se programet e kryetarit dhe programet e qeverisë nuk maten me ditë po maten me mandate. Prandaj unë konsideroj që përfundimi i mandatit po na nxen me një shkollë moderne të përfunduar dhe nxënësit me kushte të mira të procesit arsimor.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sejda e ceku shumë mirë një shqetësim të ngritur dhe qytetaret na kanë thanë çdo takim, nuk po e thamë rasisht, sepse ka qellu një person aty kur zv.ministrja, ka qenë edhe kryetari aty në Sllatinë, ku ka thanë zv.ministrja, ku thotë Lëvizja Vetëvendosje financohet prej Rusisë dhe Serbisë, edhe janë tu dhënë pare për me e destabilizu Kosovën, a po e kuptoni çfarë deklarate, është publike dhe pavarësisht që jemi në fushatë nuk bëhen këto deklarata, sepse krejt njëfemi ne. Tash prej kujt me ardh kjo, tash kur t'i shiqojmë më vonë pasqyrat financiare, e shehë se kush i merr tenderët në Komunën e Vitisë, ajo zonja, pikërisht i merr vëllau i saj krejt tenderët që ekzistojnë në Viti, pjesën dërmuese i merr ajo, e tash ajo me akuzu me qesi far akuza për Rusi e Serbi, edhe për juve nuk ju qon nderë kjo, sepse ne po jetojmë në Viti edhe e dimë saktësisht se kush dhe me çka merret, kush u kane para luftës e pas luftës kush ka shërby.

Kryesuesi, z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e KK-së.**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2020.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërtimin e bibliotekës publike komunale me emrin e publicistit dhe kritikut letrar, z.Ramadan Musliu.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2021.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të KKSB-se për vitin 2021, informatë (Raport) për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2020.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka e qes në miratim rendin e ditës. Nga të gjithë u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e KK-së

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbalin.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2020

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar këshilltar komunal! Pasqyrat financiare, e keni marr materialin me kohë, do të mundohem në disa pika me kryesore. Shifet që buxheti është ekzekutu në shumën prej 12 milion e 548 mijë nga shuma e alokuar prej 12 milion e 624 mijë. Pra, shifet që buxheti është ekzekutu në përqindje prej 99.4%, sipas kategorive ekonomike, gjithnjë këto janë parametrat që brenda për brenda vetes përmban strukturë të ndryshëm të shpenzimeve dhe që duhet në mënyrë të posaçme të verifikohet shpenzimi I tyre në mënyrë të drejtë dhe me përqindje të mirë. Pagat dhe mëditjet zakonisht janë shpenzuar 99.99%, shërbime dhe mallra 97.38%, shpenzime komunale 100%, subvencionet 94.6% shpenzimet kapitale 99.84% total buxheti është shpenzuar 99.40%. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Fillimisht fjalën ja jap shefave të grupeve parlamentare.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtori e sjelli materialin shtesë që naj lehtësoj shumë punën këtu. Mundem me e bë një konstatim tani unë, se këto përqindjet që po thuhet u ekzekutu buxheti me shtinë me dyshu për arsye se vendimet gjyqësore, ani pse e kemi përmend edhe gjatë përpilimit të buxhetit ne seancën kur u aprovu buxheti asnjëherë nuk i parashihni nëpër buxhetet komunale e që ato normal ato pare kane mu marr dikun, d.m.th shancë nuk ka 99% logjika nuk e thotë. Drejtor, ju mund të arsyetoni profesionalisht si të doni, mirëpo logjika nuk e thotë kështu nëse diçka nuk është planifiku në buxhetin e shpisë, po faktikisht ti ato i ki borxh e qare nuk e ki pa i pagu, se është vendim gjyqësor, atëherë nuk ka mundësi pa e lan naj projekt keq. Këta çka e thamë po e dëshmoj bazë të raportit që naj ke pru 418 mijë e 347 euro obligime për vitin 2021. Kuptohet që me 24 dhjetor është mbyll sistemi dhe nuk ka pas mundësi mu pagu plus 204 mijë 753 euro. Tash i llogarita që i keni borxhe të vendimeve gjyqësore. Kjo rezulton se 623 mijë euro nuk janë pare të juaja, faktikisht këto duhet mu kry obligimet kogjo shumë është pas reklamu që po lajnë borxhe, mirëpo kjo po e dëshmon ato që e kemi thanë gjithnjë, që t'i parashihni këto vendime gjyqësore edhe në buxhet, po nuk na keni vnu veshin ne momentin që i keni bë votat. Është shumë shqetësuese ramja e të hyrave të planifikuara prej 948 mijë euro në 779 mijë euro. Shumë herë po aludohet, nganjëherë me të drejtë e nganjëherë pa të drejtë, se e ka shkaktu Covid 19. Mirëpo ajo çka bënë mu shqetësu është ramja vazhdimisht edhe e donacioneve: pse po ndodhe kjo? A nuk po din mjaft me lobu kryetari apo donatorët e kanë humb besimin në ta, apo pse po ndodhë kjo. Faktikisht ne kemi prit që do të ketë rritje e duhet të ketë rritje. Kishim vitin e kaluar nëse nuk gaboj dikun rreth 60 mijë, kurse tash me ra ne 20 mijë, ramja është gradualisht vazhdimisht çdo vit. E kam një pyetje konkrete drejtor, tek shpenzimet për dreka zyrtare, e ki tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shuma është 4175 euro. Për shkak të pandemisë, ne e dimë qe nuk është mbajt "Flakadani i Karadakut", i cili ka pas një kosto: pse ka ndodhë ky shpenzim, kodi 14-310? Drejtor, vazhdimisht mesuesat janë tu majt seanca gjyqësore dhe kushtimisht edhe shumë pare do të shkojnë me vendime gjyqësore, pikërisht ato që e kemi cek edhe me Bekimin, që u nda ajo shuma për Covid 19, dikun 900 mijë euro. Po faktikisht edhe fatkeqësisht 900 mijë euro dikun 90% e asaj shume shkoj në asfalt dhe zhavorr dhe normal që me këto padi do të përballni dhe vetëm janë tu humb lëndë nga DKA-ja, nga përfaqësuesi ligjor. Drejtor, një pyetje e kam se di a mu përgjigjesh ti apo drejtori i arsimit e kemi tek kodi 13-501 mobilje, shuma totale 48 mijë e 463 prej kësaj shume bazë këtij raporti që naj keni sjellë dikun rreth 24 mijë e 178 euro janë ble banka për furnizime për shkolla. Cilat shkolla janë furnizu, a e ki informatën, kompjuter a e ki. Përgjigjen për këtë. Tek arsimi janë 56 mijë e 430 euro, e kame bë një përlllogaritje të thjeshtë, ma merr mendja qe janë lloptopa me një çmim të tregut rreth 500 euro, rezulton që janë dikun rreth 113 lloptopa. Kush ka përfitu nga këta lloptopa, a janë marr parasysh rastet sociale që nuk e kanë prindin në punë, a janë marr parasysh ato raste që me të vërtet nuk kanë pas qasje në mësimin online, edhe pse këtu u raportu një përqindje e madhe? Po unë vi nga ajo fushë, edhe të jeni të bindur që nuk kanë pas kyqje pikërisht për shkak të mungesës se teknologjisë informative. Këtë e thamë sepse ma kanë thanë edhe nxënësit. Tek pajisjet e trafikut, drejtor i ki 46 mijë e 845 euro. Vit pas viti ne buxhet ndahen mjete për pajisje të trafikut, mirëpo gjithandej mundeni me pa qe ka pajisje të dëmtuara, të shkatërruara ose që pësojnë. Ka aksidente dhe dëmtohen, mirëpo ta keni parasysh, kjo legjislaturë nuk e dinë, mirëpo me herët nëse nuk gaboj, viti 2016 në kuvend e kemi miratu edhe një plan të mobilitetit, po edhe një plan për rregullimin e trafikut në Komunën e Vitisë e që është parapa të bëhet edhe shumë intervenime në aspektin e trafikut rrugor, po që këto nuk po i shohim. Në realitet po shpenzohen paraja, po nuk po shihen. Ka shumë nevojë, janë dikun

rreth katër pika kyqe ne Pozharan, tek shkollat e ku unë edhe vet e kam kërku tek shkollat të intervenohet me pajisje të trafikut, çoftë me polic të shtrirë apo qysh të parashihen në plan të mobilitetit. Edhe një pyetje drejtor, tek kodi 14-40, mirëmbajtja e teknologjisë informatave, mirëpo këtu sipas raportit që naj keni sjellë, këtu është mirëmbajtja e instrumentit gjeodezik që ka kushtu 4176 euro. A është e arsyeshme kjo apo ka kosto, e unë nuk e njof këtë fushë, mu dok shumë e lartë kjo.

z.Bekim Azizi: Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, po e shof obligimet e bartura të pa paguara 418 mijë euro, që këtë vit nëse krahasohet me vitin e kaluar është shuma e madhe 418 mije euro. Ku janë tash këto pare, a janë mjete apo nuk janë, ku kanë mbet këto mjete që nuk janë pagu, sepse janë edhe tek shpenzimet kapitale. Ne e dimë se mund të barten një pjesë, mirëpo ka edhe shërbime dhe mallra dhe pjesë tjera që ato kanë mujtë të kryhen, mirëpo a janë paret qeto 418 mijë euro apo nuk janë. Tek detyrimet kontigjente, drejtor, këtu po e shoh që janë paraqit pagat jubilarë pas pensionit, mirëpo janë edhe pjesa e padive që janë bë, dikun 500-600 mësimdhënës që lidhen me kompensimin e kontratës kolektive. Qajo shifër është shumë e madhe e që nuk është këtu, mirëpo deshta me thanë që këtu kompensimi i pagave para luftës nëse mundesh me naj sqaru pse janë këto çfarë paga të paraluftës ka obligime komuna. Tek pjesa tjetër, bazë raporteve, unë e bëna një krahasim, shpenzimet kontraktuese ma dikun rreth 100 mije euro janë vetëm që janë pagu kontrata në vepër. Na e dimë që ka qenë një vit që nuk kanë mujt edhe punëtorët janë kanë të liruar një pjesë e madhe e punëtorëve. Unë këtu nuk shoh që ka shku diçka në rregull këtu. Na e dimë që keni marr punëtor tre muaj edhe në momentin që e keni marr nuk ka ardh as në punë, sepse është liru edhe stafi i rregullt, mirëpo d.m.th kjo është pagu. Tash shërbimet e veçanta kur të paguhen, duhet të kryhen edhe puna. P.sh.: ndryshim të shifrave, nëse krahasohet me vitet paraprake, pajisje tjera prej 77 mijëve në 107 mijë, d.m.th një krahasim: pse ka ndodhë kjo, pse janë këto shifra me të larta? Ose mirëmbajtja e ndërtesave, d.m.th dikun 20 mijë euro është më shumë këtë vit se sa vitin e kaluar. A është shtu numri i ndërtesave të vilat mirëmbahen ne 2020 apo çka ka të bëjë këtu. Mirëmbajtja e autorrugëve lokale, edhe këtu është dikun rreth mbi 20 mijë euro vlera në krahasim me vitin paraprak. Po e bëjë një krahasim ku ka ndryshime vetëm me vitin paraprak. A është kanë kontrata për mirëmbajtjen me e shtrejt apo është shtu numri i rrugëve të cilat kanë pas mirëmbajtje këtë vit. Edhe te vendimet gjyqësore kemi një shifër dikun mbi 200 mije euro. Drejtor, e di që ky vit që po vjen ka mu kane me shpenzime të gjykatave hala me i lartë. Përherë e kam përmend këtë shqetësim që është një prej shqetësimeve kryesore tek vendimet e gjykatave, sepse me vendime të gjykatave përpos që janë pagu obligimet që janë, po paguhen edhe pjesa tjetër që është kamata e ndëshkimet e te tjera vlerat po rriten mjaft shumë. Këtë vit nuk keni shku në rrugë të mbarë me menaxhim të buxhetit. E kemi dhënë vërejte edhe kur e kemi pas mjetet dikun 98 mijë euro të pagave, ato kemi mujt me e qu ne realizim të kontratës kolektive. E kam propozu atëherë nuk e keni bë edhe po na përcjellin tashi këto dënime, këto ndëshkime që do të na vinë edhe në të ardhmen.

z.Nijazi Isaku: U ceken disa çështje nga parafolësit. Unë po ndalem tek investimet kapitale ku edhe drejtori e ceku që janë harxhu 99%. Unë po ndalem tek faqja 24 robrika 14, ku flitet për asfaltimet e rrugëve rurale nga kompania "ProsioGrup" janë Viti, Drobesh, Beguncë, Lubishtë, Ramnisht, Trestenik, Terpezë, Pozharan, Sllatinë, Skifteraj, Budrikë, Smirë, vlera është 483 mijë euro e 375 euro. A janë hargju, a ka ndodhë ky asfaltim se nuk e di p.sh.: në Lubishtë nuk e di që ka ndodhë asfaltim në Lubishtë në vitin 2020, apo është që mos me ik. Paret i keni qit paraprakisht, meqenëse nuk kanë ndodhë si punime, na njofto drejtor tek numëri 22-23, hartimi i projekteve "GeoMap" dhe hartimi i projekteve Florent Emini BI, a janë, a bahet fjalë që janë një familje kjo "GeoMap", 61 mijë euro, 591 euro dhe Florent Emini 6946 euro, plus edhe tek kjo "ProsioGrup" 483 mije euro. A ka këtu konflikt interesi, kur në hartimin e projekteve merr pjese dy familjar, se siç kam informatë tash naj konfirmon ti drejtor "GeoMap" është e bashkëshortes se Florent Eminin dhe hartimi i projekteve është Florent Emini. Tash qysh ka mundësi dy persona me marr pjese në projektet në lidhje familjare ose kur dijet qysh aplikojnë edhe qekjo është shumë më rëndësi drejtor, sepse unë nuk di që ka pas rrugë të asfaltuar në vitin 2020 në Lubishtë, po edhe në Viti, nuk e di cila rrugë rurale është asfaltu, e për këtë po di me lidhe me qat deklaratën e asaj zonjës Fatbardha Emini, ku flet për financim te Lëvizjes nga Rusia e Serbia, a në anën tjetër krejt projektet i merr vëllau i saj në Komunën e Vitisë, po thuaja edhe me gjerë. Këtë ta kenë parasysh edhe qytetarët, se ne kur të flasim flasim me kësi argumente, jo vetëm me i degradu njerëzit në publik. Drejtor, për këto çështje që i ngrita na jep shpjegim.

z.Ali Bajrami: Para veti kemi pasqyrat financiare janar-dhjetor 2020. Nuk i kisha përsërit ato çka u kanë, do të fokusohem në tri çështje tek shpenzimi i buxhetit, të hyrat vetanake dhe tek buxheti që ne e kemi votuar për

vitin 2020. Rrethanat në të cilat është punu, viti 2020 ka qenë një prej viteve që ka qenë me sfida, vit pandemi dhe ballafaqimi me të gjitha vështirësitë që janë ballafaqu edhe bizneset, po edhe ekonomitë familjare tek të hyrat vetanake që është mbresëlënëse, është që 75% e kemi tejkalu dhe kemi një përqindje prej 82,16%. Kur të merren krejt rrethanat, është një ramje po jo krejt ashtu që edhe ne si ekzekutiv edhe diskutimet e bisedat që i kemi pas, ju kemi frigu që do të ketë inkasim të të hyrave shumë më të vogla. Tek shpenzimi i buxhetit në vitin 2020 ka qenë 99.40% edhe tek televizioni para nja tri jave kallxo.com, ku ka qenë kryetari, është vlerësu prej komunave me të suksesshëm, pikërisht sa i përket shpenzimit të buxhetit bile bile ka pas pyetje qyshe është arrit e qyshe është shpenzu ky buxhet tjetra çka është hala me më rëndësi buxhetin që e kemi votu edhe shpenzimet që janë në kuadër të këtij buxheti, që ne si asamblist e kemi votu e nuk e kemi shkel, e nuk ka tejkalim, prandaj krejt këto shpenzime janë të shpenzuara ne buxhetin që ne si assemble komunale e kemi miratu, që për mu është shumë me rëndësi çka ma forcon bindjen edhe me shumë kur i kemi pas pasqyrat financiare të vitit të kaluar, kam qenë i bindur dhe e kam përgëzua krejt stafin, tu fillu prej kryetarit, bordin e drejtorëve, akter që janë kryesuesi, nënkryetari. Ajo çka kam thanë, dul që buxheti për vitin 2020 ka me u shpenzu më mire se për vitin 2019. Pasqyrë e kësaj është pasqyra që janë shpenzu 99.40% prandaj nuk po thamë që nuk ka të meta, nuk ka mangësi, mirëpo krejt këto janë bë ne përputhje dhe në harmoni me Ligjin e Financave Publike.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje te nderuar të pranishëm! Sa i përket pikës për të cilën po e diskutojmë, po filloj nga të hyrat vetanake. Të hyrat vetanake janë 82.16% është bë një punë e mirë, por duhet me i falenderu edhe qytetarët që këtë vit shumë të vështirë i kanë bë pagesat e tyre, ndoshta e kanë lan veten keq dhe i kane bë pagesat që i kanë pas obligim ndaj komunës. Shpenzimet e buxhetit po shifet shifra, mallra dhe shërbime duhet ta krahasoj vetëm kur u bë harxhimi për mallra dhe shërbime, d.m.th janar-shtator janë harxhu 924 mijë 241 euro, a janar-dhjetor 1 milion e 740 mijë, d.m.th tetor-nëntor-dhjetor janë hargju 816 mijë euro. Tek subvencionet janar-shtator janë hargju 80 mijë e 488 euro, d.m.th subvencione nuk ka pas nevojë bash në kohën kur duhet me i dhënë, janë harxhu shumë pak, a janar-dhjetor 251 mijë e 600 euro. Diferenca nëntë muaj me tre muaj është 171 mijë euro. Tek investimet kapitale, Alia tha e kemi shpenzu buxhetin, po është marri qysh e kemi shpenzu këtë buxhet. Tek investimet kapitale, sipas meje d.m.th janar-shtator janë hargju 1 milion e 214617 euro, a në janar-dhjetor 2 milion e 600 e 77174 euro, diferenca nëntmuaj me tre muaj është 1 milion e 462 mijë 557 euro. Po qyshe e ka zanat me ra nganjëherë borë në tetor, a kishit muj me i hargju vetëm ne tetor jo plusult. Kjo po me shtyn me dyshu se është bë keqpërdorim këtu. Kjo ka ndodhe edhe vitet e mëparshme, edhe pushtetet e partive tjera, po kurrë në këtë mënyrë nuk është harxhu buxheti. Udhëtimet e shpenzimit zyrtar jashtë vendit, 9105 euro, çka kemi fitu prej tyre, kurgja hiq. Shpenzimet e telefonisë fikse 9305 euro, ndoshta ju doket pak kur i kemi të gjitha fal ne mes veti, telefonin mobile krejt i kemi të pagume, jemi të lidhtë në rrjet. Po dal tek kodi 13501, nuk e kemi pas këtë kod deri ne muajin e nëntë, po këto ishin kane furnizim për zyre, ku ishin ne dy vendet, 60 mijë euro me një vend dhe 48 mijë me një vend, d.m.th 110 mijë euro shpenzime për zyre, ku janë shpenzu këto para për zyre. Pajisje të trafikut janar-shtator janë kanë 32 mijë e 220 euro ne fund të vitit 107 mijë e 820 euro. Furnizimi me lëndë djegëse të drurit, d.m.th 154 mijë euro, kur ta pjestojsh me 40 euro për metër kobik të drurit, i bjen 4000 metra dru, ku janë shku këto metra dru, dyshoj se krejt jemi familjar e blemi dru, kurrë ai që ti bjen 5 metra dru kurrë nuk ti bjen mbi 4 metra dru. Këtu përmi 1000 metra janë keq përdor ose janë mënyra të ndryshme vetëm ka përfitu dikush nga kjo pune. Zyra e Kryetarit, subvencionet i kanë tepru 11 mijë e 836 euro, nuk ka vyt me i tepru asnjë subvencion, bile janë kanë pak. Tek Zyra e Kuvendi Komunal, neve naj kanë pru ka një ujë të nxehtë verës, i kanë qu ka mos furnizimi me ushqim dhe pije, mirëmbajtja e teknologjisë informative, pajisje trafiku, nuk ka pas nevojë me i bë këto prej zyrës se kuvendit. Tek arsimiti 500 mijë euro, shërbime dhe mallra janar-shtator janë hargju 152 mijë euro, a në fund të vitit janë hargju 500 mijë euro, a nëpër shkolla nuk ka pas dezinfektues ose janë kanë krejt falls. Mirëmbajtja e ndërtesave 26 mijë e 370 euro, cilat ndërtesa janë mirëmbajtje, mirëmbajtja e autorrugëve lokale janë dhënë nga arsimiti për mirëmbajtjen e autorrugëve lokale, e ku arsimiti ka pas nevojë me i shfrytëzu për veti për shkolla. Të hyrat krahasimi u kane vit akademik dhe nuk e shoh problem, jam i knaqur me ato, donacionet këtë vit i kemi vetëm 20 mijë e 40 euro donacione, investimet kapitale, p.sh.: ndërtimi i trotuareve e ndriçimet publike 373 mijë euro. Kur ta krahason ndoshta doket shumë e vogël, po përvjet me doket që 6-7 vjet ndriçimi publik e kemi pas, e tash ku po shtrohen këto apo shtrohen për se dyti a vetëm po i qoj këto pare. Rregullimi i rrugëve me zhavar, 146 mijë euro vetëm po ju njoftoj që fshati jone është një nder fshatrat me të verfura ne Komunën e Vitisë, vetëm këtë vit ka paguar 14 mijë euro për shtruarjen e rrugëve me zhavorr, asfaltimi i rrugëve rurale 960 mijë euro e pash në atë asfaltim

që e ka hi edhe rruga jone që kane mete palt pa obligime nga viti i mëparshëm, po aty u be nuk po thamë masakër e tani varet po ju lidhen ne vitin 2020, e pash që tenderët i kanë fitu vetëm dy firma nga Komuna e Vitisë që janë në za, po besoj dhe po e thamë publikisht që me këta njerëz goditen shumë lehtë këta, se këtu ka goditen njëherë sa qysh me e ba tani e merr. Tek muzeu, këtu 29 mije e 500 euro, a është kanë ajo arkiva e ofiqarisë, të gjitha dokumentet kanë qenë aty, tash ai objek është mush me zall podrumin e ne vend që me u kane arkiv e kane mush me zall e uji rrjedh, e aty kam informata të saktë që uji rrjedh. Tek krahasimi i shpenzimeve me erdh shumë intereson që shpenzimi i rrymës për 60 mijë euro është më shumë për vitin 2020. Shpenzimet e ujit janë 25 mijë 938 euro me shume se vitin 2019, dhe të gjitha shpenzimet komunalit janë me të mëdhaja: a keni pas obligime ndaj tyre apo me të vërtet janë shpenzu? Kësaj here nuk ka qenë dashur me i shpenzu këto, sepse gjysma e punëtorëve nuk kanë ardh në punë, sepse ka qenë vit i pandemisë. Derivatet e veturave këtë vit janë kanë 34 mijë me të ulëta, kjo është mirë. Autorrugë lokale 23 mijë me shumë se vitin e mëparshëm, d.m.th ky vit ka qenë një vit i vështirë po edhe harxhime që i keni bë për mu është vit fiskal me i dobëti që ka ekzistuar, është këtë vit dhe muj me thanë që besoj që viti me hajdukni që ka pas është ky vit ne bazë të harxhimeve që janë bë në tremujorin e fundit.

z.Jakup Demiri: Tek asfaltimi i rrugëve rurale, sepse po e shof këtu një shumen prej 483 mije euro në Viti, Drobesh, Beguncë, Lubishtë, Ramnishë, Trestenik, Terpezë, Pozharan, Sllatinë, Fshati i Ri, Skifteraj, Budrikë po është edhe Smira. Më kujtohet që në 2019 ishte një e tillë, unë nuk e di që ka pas asfaltim të rrugëve rurale edhe atëherë ishte kështu, ndërsa drejtori me pat thanë që i sjelli në seancën tjetër, po nuk u prit seanca tjetër mas dy dite kane ardh e kane asfaltu një pjesë pa e pytur kërkan hiq, e kanë bë edhe një lidhje të kanalizimit vetëm me bë mbulesë qet hajni që e bënë me dokumente. Unë nuk e di që është asfaltu rruga në Smirë, rrugë rurale e kam fjalën, ndërsa tek rregullimi i kanalizimi e di që ka ndodh ai kanë punu ama asfaltim i rrugëve rurale ne Smirë nuk e di që ka ndodh, edhe unë po pyes a është konflikt interesi kjo apo nuk është. Përshembull hartim i projekteve, vllau, gruaja, motra, kuanta tenderat i marrin, te njëjtat familje t'i bëjnë projektet vet e i marri tenderët, vete hartues të projekteve, vet fitues i tenderëve Floren Eminit edhe del thotë motra e ti, që Lëvizja Vetëvendosje financohet nga Rusia e Serbia. Është rrezik për Kosovë, po e thamë kështu, sepse jam rrit me një familje që nuk ka shku java pa e pa oborrin plotë polic, po ka edhe të tjerë që janë rrit me dorëza të pushtetit, e është pak e papranueshme kjo kështu. Alia tha kryetari e ka marr një mirënjohje, të gjithë kryetarët kanë marr mirënjohje prej kallxo.com, të cilët kanë pranë për me majt at emision. I vetmi kryetar që nuk e ka marr është kryetari i Klina dhe kryetari i Elezanit, sepse na tregun aty, na po jetojmë qetu, merremi me qeto shifra. Na kemi në qendër të Vitisë objekt që naj zuni edhe diellin pa leje hiq dhe nuk guxon kërkush me shku me nal. Mos më tregoni ju për qeverisjen e juaj, se ai është bë pengesë, ka mu bë edhe për gjeneratat e ardhshme edhe për njerëzit që nuk kanë le, hala jeni tu marr përgjegjësi e mos të himë në tjera ndërtime pa leje. Shpesh keni vnu shirita edhe e dini qysh jav kanë hek pa ju pytur, qetu jemi, ne po i shohim, i ki tri kompani *Floring, ProGrup, Gjomap*, krejt puna sillet rreth qetyre, edhe diksh ndoshta fiton me punë të këtyre, kemi rasti që ne rrugën Kabash-Smirë Arlindi e ka fitu tenderin po e ka punu Floring.

z.Ali Bajrami: Unë nuk thash që ka marr mirënjohje, se aty ka qenë edhe auditori i jashtëm dhe ata kanë ardh në përfundim dhe e kanë vlerësuar, ajo mirënjohje ka qenë pjese e rutinës që ata e kanë dhënë, po unë thash për punët që janë bë për ata e përmenda jo për tjetër.

z.Ibrahim Rama drejtor: Kërkoj falje për ato pyetje që nuk muj mu përgjigj, sepse u benën shumë pyetje. Më se paku 60 pyetje u parashtrun e nuk mundem për një seancë mu përgjigj. Unë po mundohem me ju përgjigj aty ku jam i saktë e aty ku nuk jam i saktë çdo kërkesë e juaja zyrtare do t'i keni shënimet e kërkuara. Asfaltimi i rrugëve rurale, janë projekte që zhvillohen në tërë territorin e Komunës se Vitisë, edhe vjet edhe sivjet edhe parvjet janë projekte dyvjeçare dhe në të gjitha këto pagesa në mënyrë të kompletuar është paramasa dhe paralogaria për secilën rrugë që është shtrur në ter territorin e Komunës se Vitisë. Si drejtor i financave po ju përgjigjem, po ju thamë me saktësi të plotë, asnjë pagesë nuk lëshohet, sepse e kam përgjegjës personale secilën dosje, secilit projekt mundohem pa shku në arkiv me e kontrollu edhe njëherë, jo për arsye që unë e kam naj problem me at dosje, po për hir që nesër në retrospektivë mos me pas kurrë kërkush problem me një dosje e me pagesë. Këtë e bëjë për secilën dosje, ku në Komunën e Vitisë vetëm ne vitin 2020 kemi pas 2200 dosje të cilat janë përpunu në Drejtorinë për Financa dhe Ekonomi, po foli për saktësinë ligjore. Në Smirë është shtrur rruga e varrezave, si informacion që tash mu kujtu, po nëse keni nevojë për të gjitha projektet i kame raportet për të gjitha rrugët anese subjektive dhe thirrjet e projekteve nuk i gjykoj. Ai mundet me qenë paragjykim nga ju, po

edhe nga unë, po në secilën thirrje publike çdo kontratë është nënshkruar në bazë të procedurave të thirrjes publike, me përjashtim të vitit 2020, të disa projekteve që janë leju të zhvillohen me procedurë të negocimit, përndryshe projektet duhet me zhvillu me thirrje publike dhe me konkurrim të drejtë për drejtë dhe tash kush të dyshon në secilën procedurë ka të drejt plotësisht me pa saktësinë. Një pyetje ishte nga këshilltari komunal për obligimet që i kemi 418 mijë euro, realisht na pare kemi të bartuara në vitin 2021, 189 mijë euro edhe perceptimi del që Komuna e Vitisë ka borxhe mbi 200 mijë euro. Pa mbulesë, nuk është e sekt, në mënyrë profesionale ligjore po e thamë. Projektet dyvjeçare kompania ka projekt dyvjeçare, ka mundësi me punu më shumë, ka financa në vitin 2020, një pjesë tjetër të financave 2021 për të njëjtin projekt. Tash kompania e ka kry punën edhe ka pru projektin. Qe po e marr një rast, asfaltimi i rrugëve me zhavar 200 e 1000 euro, që unë e kam listën e të gjithë projekteve që i kemi obligime në vitin 2021, që janë bart nga vitit 2020, d.m.th 418 mijë euro. Një prej kësaj shume, vetëm një faturë është 200 e 1000 euro, që është projekt dyvjeçar e ka kry punën, po tash pret mi marr paret. Nuk ka pagesë pa kryerje të punëve. Pate pyetje për donacionet, një pjesë e donacioneve që janë në pasqyra financiare janë donacione që mjetet i kanë qit në buxhetin e Komunës së Vitisë, ajo nuk e pasqyron nivelin e donacioneve që i ka përfitu Komuna e Vitisë gjate vitit të kaluar, por edhe gjate viteve të tjera. P.sh.: shkolla e Drobeshit nuk pasqyrohet në pasqyra financiare, ai është donacion ku ka investu niveli qendror. Rruga Viti-Sllatinë e ka participu Ministria e Zhvillimit Rajonal, e projekte të tjera. Ato mjete që nuk i kemi bë pagesën, ne nuk kemi të drejtë me i pasqyru në pasqyra financiare, po ato drejtpërdrejt merren paret në ministrin përgjegjëse, kështu që ato nuk i kemi pasqyru. Planifikimi i buxhetit, tash buxhetin e planifikojmë ne, e miratoni ju, a ekzekutohet saktë që tha Ekremi. Na edhe në KPF-në e kemi bisdu këtë çështje në periudha, pse po janë në fund të viti plotësisht pajtohem që janë profesionale dhe logjike dhe ligjore buxheti mu shpenzu në tremujor qysh është e planifikume me buxhet, po ndodh ka një her edhe faturat nuk vinë me kohë edhe punët kryhet me vonesë e kështu shumë herë grumbullohen. Tek të hyrat vetanake, po falënderimi është edhe tek qytetarët në këtë kohë të pandemisë që e kanë kry obligimet e veta, shpenzimet për trafik, kodi 13506. Po këto shpenzime janë 46 mijë euro të cilat i ka adresu dhe i ka kontrollu Drejtoria e Inspeksionit në teren. Rrugët e Komunës së Vitisë të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e shenjzimit, sinjalistikes e cila është në të mirë të komunikacionit dhe të qytetarëve, shpenzimet për mobile. Këtu keni në tri sektorë të arsimit, të shëndetësi dhe të administratës në mënyrë specifike mundeni me kërk nga drejtori me i pas shënimet e sakta për secilën. Bekimi kërk obligimet kontigjente për këto dy parametrat e parë. Selim Ademi edhe Servet Sadiku, po janë këto lande të lajmrume që 8 vite janë në gjykatë, po sipas të gjitha gjasave ato janë në gjykatë, po gjykata hala nuk ka argumente që atyre me ju kompenzu. Kontrata mbi vepër ke një pyetje, Bekimit ja kam dërgu materialin për të gjithë punëtorët që marrin pagë në emër të kontratës mbi shërbime të veçanta. Mirëmbajtja e rrugëve lokale, është operatori ekonomik, Drejtorinë e Shërbimeve Publike e kemi këtu, këto mjete janë shpenzu në kuadër të kontratës që e ka Drejtoria e Shërbimeve Publike për mirëmbajtje të rrugëve lokale dhe që kjo saktësi e kësaj shifre është përmes tenderit që është dhënë dhe punëve që janë kry në teren. Në kuadër të projekteve që janë dhënë me thirrje publike, unë nuk paragjykoj me e nda këtu naj saktësi tjetër, përveç të gjitha firmat që i kanë marr, projektet kanë qenë firma të regjistruara dhe që kanë pas të drejt të konkurrojnë në projektet e Komunës së Vitisë. Tash kush i ka marr ai sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik, ata që e kanë fitu e kanë fitu, nuk ka arsyetim tjetër, është me rendësi ne me i përcjell punët qyshe kryhen në baze të paramasës dhe parallogarisë, kurse me paragjyku kush ka të drejtë me e fitu tenderin ose dikush me shumë e dikush më pak, ajo çështje është e thirrjes publike, edhe ligji ja mundëson operatorëve ekonomik me konkuru e me e fitu tenderin. Udhëtimet jashtë vendit, nuk është që kanë ndodh në Komunën e Vitisë, d.m.th ne qeverinë komunale është ky shpenzim jashtë vendi, është një shpenzim që është bë nga projekti i bashkëpunimit ndërkuftar Kros Border, që ata kanë pas të organizuar një eskursion me persona të caktuar jashtë Kosovës dhe është pagu nga mjetet që janë ardh në komune nga Bashkimi Evropian dhe është dashtë me e pagu faturën për këtë ekskursion. Nuk është që kemi pas na shpenzime jashtë vendi, vendimet e gjykatave është afërsish 200 mijë euro shuma që është pagu në viti 2020, prej kësaj shume vetëm një operator ekonomik që borxhi është prej 2012 që naj ka marr me vendim gjyqësor është firma *Kristal*, shuma e vlerës se këtij operatori ekonomik që naj ka marr përmes thesarit mjete 150 mijë euro, pjesët dërmues e ka bë vetëm ky operator ekonomik, tjerat janë sene të imta të punëtorëve që kanë paditë për paga e mëditje, për shpenzime të tjera që janë parapa. Një problem është për shpenzimet e kontratës kolektive, të cilat prej viti 2018 i kemi të planifikuara në buxhet, jo të gjitha kategoritë, po deri në vitin 2018 kemi pas të drejtë ligjore. Buxhetin për kontratën kolektive nuk e ka nda niveli qendror asnjëherë që me i pagu këto obligime, e në këtë drejtim kemi

padi në gjykatë dhe kemi probleme me pagesën e këtyre obligimeve. Një pjesë është pagu po kemi hala pa i pagu. Të gjitha pyetjet tjera që nuk jam përgjigj, ju lutem adresoni me shkrim, ja përgatitni metilin që dëshironi me e pas.

z.Basri Aliu drejtor: Ekremi bëni pyetje, unë po i thamë që nuk qëndron ajo që nuk ka pas dezinfektus nëpër shkolla. Tek punëtorët e arsimit të cilët nganjëherë me shprehjet e tyre po e ulin edhe veten. Në këtë drejtim ja po e din ja nuk po e dine se a është investu në shkolla, p.sh.: në shkollën Skifteraj ka pas furnizimi me banka karriga, shkollën “Bafti Haxhiu”, shkolle “Njazi Pajaziti” në Radivojc, Stubëll dhe Lubishtë, gjithashtu është furnizu edhe shkolla teknike dhe disa shkolla të tjera me perde, ndërsa sa i përket furnizimit me lloptop, ju njoftoj se janë furnizu 88 lloptopa dhe shpërndarja është be sipas numrit të nxënësve nëpër shkolla, po jo nxënësve po janë inventar të shkollave, sepse ne nuk kemi të drejtë me dhënë subvencione prej shërbimeve dhe mallrave për nxanësa, prandaj këto janë inventar për shkolla dhe shkolla e juaj sa e di unë sipas numrit të nxënësve i ka marr 5 lloptopa dhe 5 projektor nëse nuk gaboj.

z.Sejdi Emini: Drejtor, nuk konsideroj që bënë naj fyerje ndaj teje personalisht dhe ndaj askujt tjetër. Ne pikërisht e kërkuam me i ik fyerjeve, mirëpo një diçka që është reale, që është përgjegjësi, qëllimi im ke që ju vetë me dëshmu që ai projekt ka qenë kërkesë e shkollës, e ka pru kërkesën e shkollës në komunë, komuna e ka dërgu në Prishtinë dhe ju mos u thirrni në fushat që e keni kry projektin në shkollën e Goshices, ti vet e dëshmove me gojë tanë, që as çmimin e faturën nuk po e dinë sa kushton. Kurrë në jetë mos medo që ka më të fyej në personalitetin tanë, po kurrë në jete nuk ta lejoj.

z.Basri Aliu drejtor: Sejdi, po shpresoj që para nxënësve nuk sillesh kështu, se po mendoj që je një edukator i mirë. Projektet që i financojnë të tjerët dhe janë proceduarat se nuk ka hi vetëm shkolla e juaj, ka hi edhe shkolla e Zhitisë. Sigurish e keni edhe një rregullore që këshilltarët duhet me e ditë që nëse e bëjnë punën në muaj mu përgjigj edhe me vonë është e drejtë ligjore të e bënë pyetje. Unë nëse muj me tu përgjigj, përgjigjem, tani nëse jo në seancën tjetër ta bi me shkrim, prandaj duhet me pas kujdes edhe në fjalor.

znj.Mirlinda Sadiku: Si duket jemi keqkuptu, e di që nuk ka mundësi gjithsecili person me i ditë të gjitha absolut. A e din pse aludova në atë aspekt, sepse një kohë ke qenë drejtor i shëndetësisë me një kohe e ke lujt të dy pozicionet, ka ekzistiu mundësia mos me i pasë të gjitha informacionet, absolut nuk kam pas tendenca për me të ofendu kurrfarë mos e merr personale, mirëpo tu nis prej aspektit se di drejtori të gjitha drejtorit i raportojnë kryetarit, ajo është vija institucionale, prandaj edhe për qata që raporton për drejtori dhe je drejtor, normal që na kërkojmë informacione. Nëse nuk e ki informatën ne këtë seancë e presim seancën tjetër. Nuk ka kugja të keq këtu, ama mos e merr ti personale.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërtimin e bibliotekës publike komunale me emrin e publicistit dhe kritikut letrar, z.Ramadan Musliu

z.Milot Lala, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Meqenëse jemi në seancën e parë të vitit 2021, më lejoni që t’i ngushëlloj të gjithë familjarët për humbjen e me të dashurve të tyre. Ne kemi sjellë në këtë seancë propozimin e bibliotekës publike komunal me emrin e publicistit dhe kritikut letrar, Ramadan Musliu. Materialin e keni pranuar me kohë, kërkoj që ta votomi këtë propozim vendim. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Naim Pira kryesues: Ju falënderoj që keni sjell këtë propozim vendim. Besoj që kuvendi për këtë pikë do ta këtë votën pro nga të gjithë këshilltarët. Hapi debat për këtë pikë.

znj.Mirlinda Sadiku: Absolut nuk kam çfarë të shtoj, jashtëzakonisht bukur e paska thanë edhe Jakupi në Komitetit për Politik dhe Financa. Normal që i bënë nderë, mirëpo për ta nderuar edhe pak më shumë emrin e këtij njeriu të madh që e ka Vitia, i cili vdiq fatkeqësisht, do të ishte mirë drejtor që pe shohë këtu vitin 1976, Radivojci ka pas bibliotekë. E di që e ka një kontest gjyqësor, a ka mundësi këto biblioteka të funksionalizohen prapë, sepse kemi shumë biblioteka jo funksionale. Tek biblioteka e fëmijëve po ka mungesa të shumta të librave për me lartësu emrin e këtij duajeni të Vitisë. Normal që do të ishte funksionalizimi i këtyre bibliotekave, po pse jo edhe të vizitohet edhe nga nxënësit pak me shumë kur të ka mundësi, me pas edhe libra më shumë. Lëvizja Vetëvendosje absolut jemi pro këtij propozim vendimi dhe na bënë nder që jemi pjesë e këtij votimi.

z.Naim Pira kryesues: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qese në votim për miratim. Nga të gjithë që ishin prezent u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të katërt kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2021

z.Naim Pira, kryesues: Unë kame qenë i kujdesshëm po thuaj që në të gjitha vitet që para kuvendi të sjellim orarin e mbajtjeve të takimeve. E di që ndoshta sun ja qëllojmë bashë boll, për shkak se mund të ketë lëvizje, po si do çoftë unë e kam sjellë para juve. Nëse nuk ka dikush për të diskutuar, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021

z.Naim Pira, kryesues: Ne e kemi themelu këtë komitet dhe ata e kanë sjellë propozimin e tyre. Unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të KKSB-se për vitin 2021, informatë (Raport) për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2020

z.Naim Pira kryesues: Materialin e keni pranuar me kohë, unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Nëse nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Naim Pira

